



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda: STATISIKË PËR GAZETARËT

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Asoc. Dr. Elena Myftaraj (Tomori)
<i>Ngarkesa:</i>	2 ETCS (15 javë: 1.5 leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Statistika është një element i rëndësishëm në raportimin e lajmeve të ndryshme në media. Dhe në shumë raste konsiderohet si përbërësi kryesor i lajmit të vërtetë ose i faktit të vërtetë. Kjo është një ndër arsyet që një gazetar duhet të jetë i pajisur me aftësi të tilla që të kuptojë, interpretojë të dhëna të ndryshme statistikore në mënyrë të pavarur, kritike dhe të kujdesshme. Një gazetar i aftë duhet të dijë se çfarë të pyesë dhe në mënyrë të saktë dhe të informojë publikun në një mënyrë të drejtë. Pajisja e studenteve me njohuri bazë statistikore për praktika të ndryshme të gazetarisë, rritja e nivelit të njohurive të studentëve me praktikatat e mira dhe të këqija të raportimit në media; zhvillimin e aftësisë së studentëve për të komunikuar lajmë të ndryshme nëpërmjet argumentave statistikore si dhe për të shpjeguar dhe vlerësuar cilësinë e prezantimit statistikor të lajmeve në media si dhe të aftësojë studentët e kësaj dege të realizojnë analiza të thjeshta statistikore në praktikatat e punës së tyre nëpërmjet aplikimit të njohurive të tyre në këtë fushë.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje në Statistikë: raportimet statistikore, rregullat e tyre, prezantimit i lëndës.
2. Disa elementë bazë të përdorimit të statistikës në fushën ekonomike: frekuencat, përqindjet, probabiliteti, indekset etj
3. Statistika përshkruese: Paraqitja grafike dhe tabelare e të dhënave.
4. Prezantimi dhe përshkrimi i të dhënave: mesatarja , moda , mediana, kuartilet, varianca dhe devijimi standard.
5. Vlerësimi pikësor për tregues të ndryshëm në zgjedhjet statistikore. Popullimi dhe zgjedhja, zgjedhja e rastit, shpërndarja e zgjedhjes e mesatares.
6. Nxjerrja e konkluzioneve nëpërmjet të dhënave statistikore: Kontrolli i hipotezave statistikore bazuar në të dhënat e zgjedhjes.
7. Vrojtimi me zgjedhje: teknikat e studimit, studimi eksperimental dhe lloje të tjera studimi. 8. Statistike të avancuar: shpërndarja normale dhe përdorimi i saj në praktike.
9. Lidhjet korrelative: korrelacioni dhe lidhja regressive midis dy variablove.
10. Përdorimi i excel dhe i internetit.
11. Përdorimi i numrave dhe të dhënave statistikore në shkrime të ndryshme.
12. Përmbledhje e lëndës, koncepteve dhe elementëve të saj.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në:	
- Angazhimi në seminare:	10% e notë
- Testi kontroll i pjesshëm i dijeve :në javën e 10-të	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	70% e notës
Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

Leksione të parashkruara të lektorit të lëndës

Literatura plotësuese:

1. *Working with numbers and statistics*- Charles Livingston , Paul Voakes
2. *Basic Statistical Concepts in Education and the Behavioral Sciences*. Albert Bartz
3. *Statistics for the Social and Behavioral Sciences*. David Kenny
4. Anderson “Leksione të statistikës” (përkthim dhe përshtatje)